

Komuna e Vushtrrisë: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Vushtrrisë aktualisht udhëhiqet nga Bajram Mulaku i cili vjen nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Për z. Mulaku ky është mandati i dytë qeverisës.
2. Pas zgjedhjeve lokale të 2007, PDK ka arritur marrëveshje koalicioni me Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Partia e Drejtësisë (PD) për të bashkë-qeverisur Komunën e Vushtrrisë. Në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë prej 35 asambleistëve sa janë gjithsej, PDK-ja ka 15 përfaqësues, AAK-ja dhe LDK-ja ndajnë numrin e njëjtë të ulëseve, përkatësisht nga shtatë asambleistë, përcjellur nga AKR-ja me dy asambleistë. Ndërsa nga një ulëse e ndajnë Partia e Drejtësisë (PD), Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), Lëvizja për Bashkim (LB) dhe Partia Demokratike Turke e Kosovës (PDTK).
3. Ekzekutivi i komunës së Vushtrrisë përbëhet prej 12 drejtorive.
4. Sipas statistikave të regjistrimit të popullsisë, Vushtrria ka 71.042 banorë.¹
5. Hulumtimi i UNDP-së “Mozaiku i Kosovës 2012”, konstaton se 65% e banorëve të Vushtrrisë konsiderojnë se janë autoritetet lokale ato që duhet t’i zgjidhin problemet komunale, ndërsa 15% vlerësojnë se ato probleme mund t’i zgjidh vetëm niveli qendror.²
6. Në hulumtimin e bërë nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet kryesore që ka pasur në atë kohë Vushtrria kanë qenë: mungesa e ujit të pijes, mbeturinat dhe ndotja e ambientit, rrugët e ngushta dhe mungesa e trotuareve, mungesa e urës në fshatin Prelluzhë si dhe mungesa e përkujdesjes ndaj trashëgimisë kulturore.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 126. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

Problemet kryesore të Komunës së Vushtrrisë 2013

- 1. Mungesa e ujit të pijes.** Qyteti i Vushtrrisë dhe gjitha fshatrat ballafaqohen me reduktime të gjata dhe të shpeshta të ujit të pijes. Komuna, në bashkëpunim me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, ka ndërtuar fabrikën e re të ujit në fshatin Balincë, por që nuk është funksionalizuar ende.³ Rrjeti i ujësjellësit përgjithësisht ekziston në këtë komunë, në përjashtim të Zonës së Shalës ku gypi kryesor është instaluar, por shpërndarja deri të shtëpitë nuk është bërë. Banorët e kësaj zone e kanë të vështirë lidhjen me gypin kryesor për shkak të kostos që kërkohet për lidhje në gyp dhe distancës së gjatë mes shtëpive dhe gypit. Problemin me furnizim me ujë për banorët e Vushtrrisë e ka argumentuar edhe hulumtimi i UNDP-se. Vetëm 5% e banorëve të kësaj komune kanë furnizim të pandërprerë me ujë të pijes, përderisa për 25% të banorëve ndërprerjet në ditë sillen nga 1 deri në 4 orë, 5% kanë ndërprerje nga 5 deri në 10 orë, ndërsa 18% janë deklaruar së reduktimet u zgjasim më shumë se 11 orë në ditë.⁴
- 2. Deponitë ilegale dhe qyteti i papastër.** Në qytetin e Vushtrrisë dhe pothuajse në të gjitha fshatrat e kësaj komune janë prezentë deponi ilegale mbeturinash. Kjo situatë është krijuar për shkak të mungesës së kontejnerëve për hedhjen e mbeturinave duke ndikuar që qytetarët vushtrrias t'i hedhin mbeturinat në vende jo të destinuara për mbeturina. Vetëm në fshatin Pestovë janë mbi pesë deponi ilegale. Deponi tjera ilegale të mbeturinave ka edhe në “Rruga e Drenicës” në fshatin Begaj, po ashtu në fshatin Karaçë, Novosellë e Begut, Novosellë e Maxhunajt, Dumnicë e Lluges, Stanoc, Gracë dhe Prelluzhë. Sipas hulumtimit të UNDP-së, 38% e qytetarëve të Vushtrrisë e konsiderojnë të papastër qytetin e tyre, përderisa 29% të tillë e shohin lagjen e tyre.⁵
- 3. Nxjerrja e thëngjillit në Zhilivodë.** Fshati Zhilivodë është bërë vend biznesi dhe përfitimi për disa kompani private e po ashtu

³ Aid Management Platform. Burimi: <http://public.amp-mei.net/search/38/95/39>

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim -UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 160. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim -UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 160. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

edhe për disa fshatarë vendas të cilët vazhdimisht nxjerrin thëngjill. Nga një veprim i tillë ilegal⁶ janë krijuar një numër i madh i pusetave të thella ku nga gërmimi për thëngjill shumë zona në Zhilivodë janë bërë kërcënim për jetën e banorëve . Pikërisht në këto puseta artificiale, në qershor të këtij viti, një 17 vjeçar ka humbur jetën pasi kishte rënë në një rën prej tyre e cila ishte e thellë rreth 8 metra.⁷

- 4. Ndotja e lumenjve.** Komuna e Vushtrrisë është ndër komunat e pakta në Kosovë që e përshkojnë tre lumenj. Por, lumi Sitnica, Terstena dhe lumi Studimja janë të ndotura. Vetëm në lumin Tërstena hidhen mbeturinat e fshatrave Karaçë, Novosellë e Begut, Dumnicë. Një lum tjetër që përshkon tërë Kosovën, lumi Sitnica, është gjerësisht i ndotur nga banorët e fshatit Pestovë.⁸ Ndërsa, në fshatin Samadrexhë në Lagjen e Bonjakeve, përveç që hidhen mbeturinat në lumin “Studimja”, aty derdhen edhe ujërat e zeza. Banorët e këtij vendi disa herë e kanë pastruar në mënyrë vullnetare këtë lum. Në lum janë hedhur edhe materiale ndërtimore.
- 5. Mungesa e kanalizimit.** Një problem tjetër i vazhdueshëm me të cilën ballafaqohen banorët e komunës së Vushtrrisë është edhe mungesa e rrjetit të kanalizimit. Ky problem po ndikon në masë të madhe në ndotjen e mjedisit e sidomos në shpërndarjen e ujerave të zeza të cilat po i ndotin burimet e ujit të pijes në ato vende ku nuk ka ujësjellës. Nga sasia e madhe e ujerave të zeza po ndoten edhe lumenjtë Sitnica dhe Tërstena pasi këto ujëra po derdhen në to. Rreth 60 fshatra të Komunës së Vushtrrisë nuk kanë fare rrjet të kanalizimit përgjatë vendbanimit të tyre. Të tilla janë fshatrat Akrashticë, Pantinë, Oshlan, Strofc, Zhilivodë, Samadrexhë etj.
- 6. Mungesa e vendndalimeve për autobusit.** Qyteti i Vushtrrisë nuk e ka vendndalime të posaçme për marrjen dhe zbritjen e udhëtarëve nga autobusët. Për të kryer këtë veprim autobusët ndalen në rrugë dhe kjo krijon tollovi në komunikacion.
- 7. Mungesa e parkingjeve.** Qytetarët e Vushtrrisë si problem të vazhdueshëm e kanë mungesën e parkingjeve publike pasi komuna nuk u ka vënë në dispozicion parkingje të mjaftueshme. Mungesa e parkingjeve i shtyn vozitësit që

⁶ Nxjerja e thëngjillit kërkon pajisje me leje të veçantë nga Komisioni për Miniera dhe Minerale.

⁷ Portali “Koha.net”. “Një 17 vjeçe humb jetën në pusetën e thellë 8 metra”, 31.08.2012 . Burimi: <http://www.koha.net/?page=1,4,155267>

⁸ Portali “Koha.net”. “Patatet e pashitura tani ndotin ambientin”, 03.05.2012. Burimi: <http://www.koha.net/?page=1,31,98028>

veturat t'i parkojnë në trotuare dhe në vendet e tjera jo adekuate.

8. Mungesa e çerdheve. Komuna e Vushtrrisë ka vetëm një çerdhe publike. Kapacitetet e saj janë për pranimin e 80 fëmijëve gjatë një viti, ndërsa pranohen deri në 170 fëmijë, shkak i kërkesave të mëdha dhe mungesës së çerdheve tjera publike.⁹ Kjo ka shtyrë subjekte dhe individë të ndryshëm që të hapin çerdhe private, por qytetarët më shumë preferojnë çerdhet publike.¹⁰

Gjërat pozitive të cilat duhet ruajtur dhe mirëmbajtur

1. Kalaja e Vushtrrisë. Kalaja e Vushtrrisë është njëra prej ndërtimeve antike të pakta në Kosovë që i ka shpëtuar rrënimit. Kalaja, sipas mënyrës së ndërtimit, përbërjes së materialit ndërtimor dhe të dhënave tjera, është ndërtuar në mesjetë. Projekti i ristrukturimit të Kalasë së Qytetit ka filluar në vitin 2008, fillimisht duke bërë gërmimet arkeologjike nga Instituti për Mbrojtje të Monumenteve, e më vonë janë vazhduar nga Instituti Arkeologjik i Kosovës. Ndërsa projekti për rivitalizimin e Kalasë nga një organizatë suedeze dhe e sponzorizuar ga Ambasada Amerikane në Kosovë pritet të përfundojë këtë vit ku është premtuar që pamja e kalasë do të jetë më tërheqëse.

2. Hamami i Vushtrrisë. Sikurse Kalaja e Vushtrrisë, edhe Hamami i këtij qyteti është një monument i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore të Kosovës. Hamami i Vushtrrisë besohet të jetë ndërtuar në mesjetë, përkatësisht në shekullin e 15-të. Sikurse Kalaja, ashtu edhe Hamami i Vushtrrisë i është nënshtruar rivitalizimit me qëllim që ai të jetë më tërheqës për turistët.


⁹ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e arsimit ne Kosovës 2012/2013. Fq 5. Burimi: http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Statistikat_e_Arsimit_neKosove_2012_13%201.pdf

¹⁰ Portali lokal "VushtrriaInfo". 25.01.2013. Refuzohen 80 kërkesa të prindërve që kërkojnë kujdes nga çerdhja e vetme publike. Burimi: <http://vushtrria.info/?p=119>

Trendet Buxhetore në Komunën e Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë ka planifikuar 12.6 milion euro buxhet për vitin 2013. Krahasuar me vitin 2010 buxheti i kësaj komune është rritur për 2.6 milion euro (26%). Kjo rritje ka ardhur më së shumti nga rritja e grantit qeveritar. Krahasuar me vitin 2010, të hyrat vetanake kanë pësuar një rritje të lehtë prej 66 mijë euro (6%) dhe në total kanë qenë 1.2 milion euro. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm¹¹ ka gjetur se kjo komunë ka realizuar vetëm 65% të të hyrave vetanake në vitin 2012.

Figura 1. Buxheti i Komunës së Vushtrrisë- 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?vushtrri/2013#/~-/vushtrri>

¹¹ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiarë të Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012, 09 Shtator 2013, http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KVU_2012_Shqip_255524.pdf

Në bazë të grafikomit të mëposhtëm rreth trendeve buxhetore shohim së krahasuar me vitin 2011 investimet kapitale kanë rënë për 700 mijë euro (18%) në vitin 2012. Kur jemi tek shpenzimet, ZAP-i ka konstatuar se komuna ka vendosur kontrolle të mira mirëpo ka gjetur raste: 1) të vonesave të punëve dhe; 2) mungesë të komisioneve për pranim të mallrave

Figura 2. Trendet Buxhetore 2010- 2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2014-2016 shohim se Komuna e Vushtrrisë ka planifikuar një rritje thelbësore në buxhet, sidomos nëse krahasojmë vitin 2014 me vitin e tanishëm. Në bazë të planifikimeve të kësaj komune kjo rritje do vie si pasojë e rritjes së grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake. Kjo rritje e të hyrave vlerësohet të reflektojë tek të gjitha kategoritë e shpenzimeve me theks të veçantë tek ato kapitale.

Tabela 1. Buxheti 2014-2016

	2014	2015	2016
Të hyrat totale	13.419.233	13.789.317	14.082.491
Të hyra vetanake	1.652.000	1.701.560	1.735.591
Granti Qeveritar	11.767.233	12.087.757	12.346.900
Shpenzimet Totale	13.419.233	13.789.317	14.082.491
Paga dhe mëditje	7.438.075	7.486.542	7.486.542
Mallra dhe shërbime	1.240.548	1.263.976	1.286.799
Komunalit	259.755	275.312	280.855
Subvencionet dhe Transferet	195.000	220.000	232.000
Shpenzime kapitale	4.285.855	4.543.487	4.796.295

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorim të fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulamtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Dragashit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj.

Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulumtimeve më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.